

URDHËR
Nr. 58, datë 18.1.2024

**PËR DELEGIM KOMPETENCASH, PËR NËNSHKRIMIN E URDHRAVE, PËR
NXJERRJEN NGA PËRDORIMI DHE SHKATËRRIMIN E NDËRTESAVE
EKONOMIKE NË ADMINISTRIM TË STRUKTURAVE NË VARTËSI TË
MINISTRISË SË MBROJTJES DHE SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FORCAVE
TË ARMATOSURA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të shkronjës “P”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; të pikës 103, 118.1 dhe 118.2, të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Kompetenca për nënshkrimin e urdhrave për nxjerrjen nga përdorimi dhe shkatërrimin e ndërtesave ekonomike në administrim të strukturave në vartësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura i delegohet zëvendësministrit të Mbrojtjes, zotit Enkelejd Joti.
2. Ngarkohet zëvendësministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Niko Peleshi